

NACIONAL

Gazeta e përditshme online:
www.gazeta-nacional.com

Adresa: Ish-kinostudio "Shqipëria e re", Tiranë
E-mail: nacionalalbania@yahoo.com, bucpapaj@yahoo.com

Panairi u shtrydh si limoni për të shpëtuar "shijen" e tharët të politik-letrarëve

"Kohë e pamjaftueshme në Qytetin e Panairit të librit"

Nga Ilir Paja faqe 5



Gregory Crewdson, përgjegjës për radikalizimin në fushën e fotografisë

Fotografi e vështirë

Nga Gjekë Marinaj faqe 3



EDITORIAL

Angazhimi i qendrueshëm i SHBA-ve

Nga Filip Gordon



Faleminderit që më keni ftuar këtu sot për të folur mbi gjendjen në Ballkanin perëndimor. Ndërkohë që ngjarjet dramatike të Pranverës Arabe

mbizotërojnë në kryetitujt e shtypit, Administrata Obama vazhdon të jetë po aq e përkushtuar sa përherë për të ndihmuar vendet e Ballkanit perëndimor në rrugën e tyre drejt integritimit Euro-Atlantik. Hera e fundit që kam qenë atje ishte në qershor...

Faqe 18-19

Në perkujtim të Ndre Mjedës

Nga Aldo Bumçi



Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve zoti Aldo Bumçi mori dje pjesë në Kukël në hapjen e muzeut Ndre Mjeda, konkretisht të kishës ku shërbeu

Mjeda apo të shtëpisë (qelës së tij). Zoti Bumçi shprehu edhe një herë prioritetin që qeveria dhe MTKRS i japin trashëgimisë kulturore dhe objekteve të tilla me rëndësi për kulturën tonë kombëtare, dhe turizmin kulturor. Ky ingagurim u bë në 74-vjetorin e vdekjes së poetit dhe...

Faqe 16

A po dëmtohet apo rrezikohet sistemi letrar në vendin tonë

Një popull meriton atë letërsi që ka

Nga Prof. Dr. Anton Pappleka faqe 4



Moderatori i emisionit "Ora e Kulturës", Aulon Kalaja replikon me botuesin Henri Çili

"Ora e Kulturës", një rast për të përfituar kulturë

faqe 11

Në BRENDËSI

Hijet që ënden

Nga Pascal Quignard

faqe 10

Plazhi nudo

Tregim nga Sulejman Mato

faqe 9

"Post Hekuba"

Libri i ri poetik nga Yllka Filipi

faqe 21

Leximi i një fotoje

Esse nga Qamil Gjyzezi

faqe 16

Preç Zogaj, botohet në SHBA

faqe 21

Ciganja

Novelë nga Spiro Mëhilli

faqe 14

"Për Kombin, për Demokracinë"

Nga Azgan Haklaj

faqe 20

Prozë nga:

Antigona Marku, Lori Hoxha, Besnik Avdiaj

faqe 6-15

Poezi nga:

Agim Mato, Yllka Filipi, Ismet Tahiraj,

faqe 7

UNIVERSITETI KRISTAL
UK

Radio Nacional
93.6 Mhz
www.radioliberal.al

MREKULLIA E NATYRES SHQIPTARE!
Cajthiza
Uji Natural

RADIO NACIONAL
93.6Mhz

Gregory Crewdson, përgjegjës për radikalizimin në fushën e fotografisë

FOTOGRAFI E VËSHTIRË

Të bësh emër ditët e sotme, kërkon të shpenzosh gjithçka. Të shplohesh nga gjithë shqetësimet e tua, sigurisht që të ndihmon shumë.
—Gary Portnoy dhe Judy Hart Angelo

Nga Gjekë MARINAJ



Në foto: Gregory Crewdson

Të qenit i famshëm në dhjetëvjeçarën e parë të shekullit të 21-të e cilëso fushë të jetës qoftë ajo, është tepër e vështirë, por të qenit i njohur në mbarë botën si fotograf për një kohë të shkurtër, nëse nuk do të jesh Gregory Crewdson, mbetet thujse joreale. Kjo sepse, arti i fotografisë, që në fazat fillestare të tij perceptohej nga shumica si një mjet që do të ndryshonte botën dhe që e kishte ndryshuar atë radikalisht. Gregory Crewdson është po aq përgjegjës për këtë lloj radikalizimi në këtë fushë, sa asnjë tjetër. Ai krijon imazhe që depërtojnë thellë në labirinthe të fshehta të jetës. Pa frikën e trajtimit të aspekteve të diskutueshme, të mistershme dhe të rrezikshme të jetës, ai u kthye në një nga artistët e preferuar për shumicën e njerëzve, pavarësisht interesimit të tyre për artin. Përpjekja për të krijuar një univers artistik, ku problematika lidhet me shikuesit, diku në kufijtë e errët fiktivë dhe të mjedisit realist është njohur dhe përqafuar gjithashtu nga grupmosha e tij. Duke qenë tepër i ndërgjegjësuar për atë që rregullonte aspektet e paqëndrueshme të jetës përmes artit, Crewdson-i u shndërrua qëllimisht në një nga lidhjet e forta midis veprave të tij natyrore dhe supernatyrore. Edhe pse reputacioni i tij për të bërë, jo për të marrë fotografi u mirë prit, fotografitë e tij do t'i çmendnin njerëz të tillë si Peter Henry Emerson. Ashtu si shumë tradicionalistë të sotëm, Emerson-i kërkonte që fotografia të jetë e dokumentuar dhe jo thjesht të ketë forcën argumentuese artistike, "fotografia duhet të pasqyrojë vetëm botën reale, ndryshe nga fotografët tjerë si Henry Peach Robinson, që 'i skenonte ngjarjet dhe i stamponte shumë prej negativeve në përfitim të vizionit artistik'" (Siegel, 85). Por, kjo ese do të diskutojë rreth vizionit të pakrahasuar artistik, që përbën një aspekt të rëndësishëm në suksesin e Crewdson-it si fotograf. Mbi të gjitha, veprimtaritë e tij përbëjnë gjithë organizimin intelektual dhe imagjinatën krijuese gjatë parapërgatitjes së punës ngulmuese me dorë dhe marrjes së rrezikut gjatë saj, si dhe e një talenti dhe mjeshtërie të madhe pas procesit përfundimtar të veprave të tij. Crewdson sipas këtij kuptimi tregoi të vërtetën mbi konotacionin kryesor të tekstit të këngës të Gary Portnoy dhe Judy Hart Angelos ku thuhet, "Të bësh emër ditët e sotme kërkon të shpenzosh gjithçka". Gregory Crewdson nuk harron asgjë kur bie fjala për të krijuar një foto të madhërishtme.

Albumi i Crewdson-it me titull "Muzg" Twilight (1998-2002) përbëhet nga disa foto digjitale -C pa titull, me përmasa mesatare 129.9 x 152. 4 cm (48 x 60 inç), pasi shumica e ve-

prave të tij është një nga burimet e shkëlqyera të realizimit të konotacionit të vërtetë të pamjes së madhërishtme artistike. Ky është një nga albumet që pasqyron me të vërtetë forcën e imagjinatës krijuese dhe aftësinë e përgatitjes së jashtëzakonshme të punës. "Crewdson-i erdhi më parë me idenë për shpërthimin e brendshëm, ndërkohe ekipi i tij filloi punën, së pari duke krijuar foto bardh e zi dhe më pas foto me ngjyra më të forta

sideron real peisazhin e fotografit amerikan. Crewdson-i, ashtu si në shumë foto të albumit Muzgu -Twilight, "tërhiqet nga mitet e njohura të kinemasë hollivudiane dhe i përdor ato për të krijuar fotografi të së kaluarës së shoqërisë amerikane që izolohehen prej saj dhe kërkojnë në zbrastësinë e psikikës unike të sëmurë" (Berg, 11). Në veprën e Crewdson-it, ky izolim u trajtua ligjërisht si fenomen që rrezikon më të keqen,



Foto nga Gregory Crewdson

sipas versionit të tij. Pas dy - tre ditëve do të duhej aktualisht të krijohej fotoja përfundimtare për të cilën merren mbi 40 apo 50 poza" (OSW 44). Një nga fotot më të çuditshme të këtij koleksioni është fotografia pa titull e vitit 2001, e cila mori titullin e sugjeruar, Ophelia nga Perëndimi - Ophelia from Twilight. Ajo është foto digjitale -C me përmasa (129.9 x 152. 4 cm) që mund të merret si modeli kryesor artistik i albumit. Po të konsiderojmë talentin dhe faktin se Crewdson-i u lind në vitin 1962 në Bruklin të Nju Jorkut dhe u rrit duke dëgjuar psikoanalizat e babait me pacientët e tij në zyrën në papafingo, atëherë nuk kishte çfarë të prisje tjetër. Po t'i drejtohem Ophelisë së Shekspirit tek Hamlet-i, tema e tij paraqet një vajzë të bukur, e cila është mbytur, por kësaj here jo në lumë, si tek vepra Hamlet, por në katin e parë të shtëpisë dy katëshe. Ajo gjendet e shtrirë, e vdekur me të brendshme të bardha transparente dhe pamje shumë të ëmbël e të pafajshme, e zhytur në gjysmë metri ujë. Mbi tavolinën e kafes, afër një gote më shumë se gjysmë plotë, gjendet një shishe e zbratur me ilaçe. Fustani i saj është ngjyrë rozë, kurse pandoflat i duken qartazi mbi shkallët e ndriçuar nga drita e diellit, e cila vjen prej dritareve. Aty shihet një tavolinë me dritë dhe muri më i lëmuar nga drita. Goja e hapur tërheq paksa vëmendjen e shikuesve. Ngjyra e zbehtë e lëkurës së saj është në harmoni me mjedisin. Kuptohet se personi ka vdekur, pasi në dhomë nuk ka asgjë të dukshme që vërteton se ka trup të gjallë. Pjesa më e madhe e trupave gjeometrike duken si pikëçuditëse të cilat e përqendrojnë vëmendjen tek viktima e vetë. Ophelia nga Perëndimi, nuk mbështet plotësisht në traditën e Walker Evans-it, Gery Winogrand-it dhe William Eggleston-it, edhe pse e vet kon-

nese shoqëria jonë zgjedh të mos t'i kushtojë rëndësi forcës negative.

Vepra e Crewdson-it kërkon shumë punë gjatë procesit që e quan "krijimtari", e cila e gjen atë në rolin e regjisorit. Ekipi i punës shpesh herë përbëhet nga 40 - 50 vetë. Gjatë kësaj faze, synon të gjejë rrugën unike artistike që e çon në format më të thella të krijimtarisë. Atje krijon shtrësat e kuptimit që shpreson të arrijë. Këtu jepet përshkrimi i vet Crewdson-it për atë momentin e rëndësishëm: "Kjo është ora e magjisë. Era pushon dhe gjithçka qetësohet. Në atë çast, gjithçka, qoftë edhe një gjethë që lëviz është shkëputje nga bota e përsosur. Tërhiqem më tepër nga muzgu për qetësinë e tij, se sa për dritën," mendon ai si përfundim. "Ky është çast përsosmërie. Më pëlqen shumë ai çast, sa me të vërtetë jetoj për të" (Helmores 5). Ky është çasti, kur parimet e planifikimit vijnë në jetë. Performanca nuk është as e re, as proces i veçantë për foton digjitale. Në disa nga fotot e tij, sidomos ato të përzgjedhura për albumin me titull "Poshtë trëndafilave" Beneath the roses, vepër e krijuar nga viti 2003 - 2005 me mbështetjen e ekipit dhe me të njëjtin buxhet si në disa nga filmat hollivudiane, pëlqehet nga artistë të pavarur dhe nga fotografë të filmave dokumentarë, ndaj gjithë veprat e tjera janë foto digjitale -C pa titull me përmasa 144.8 x 223.5 cm). Duke pasur njerëz të pamirëpritur, ndërsa pozojnë kudo nga 40 - 50 fotografi të ndryshme në ditë me përmasa 8" x 10", do të ishte ndoshta pak çudi për ekipin, por me sa duket, Crewdson-i e pranon këtë metodë pune: "Për mua nuk ka problem kjo pjesë, por mbetet e çuditshme. Këtu ka një punë konfuzë, të ankthshme: ku disa syresh shpenzojnë shumë të merren me probleme të tilla dhe gjithçka arr-



Në foto: Gjekë Marinaj

ijnë është pika e vlimit dhe pas kësaj, kur fotoja është bërë, vjen paqja dhe qetësia e cila izolohehet nga e gjitha kjo" (Ayers Artforum.com). Ndërkohë përfundimi i punës jashtëzakonisht të madhe ndonjëherë kritikohet nga kritikë si Jerry Salts, i cili mendon se vepra e tij në tërësi është e madhërishtme, por "së fundmi këto foto u shndërruan ndoshta në tepër të çuditshme dhe melodramatike" (Saltz 1). Saltz-i, sigurisht që ka të drejtë të vlerësojë artin sipas kritereve të tij, por arti i fotografisë nuk do të thotë pozë. Pavarësisht faktit që ndoshta iu ngarkua nga procesi i vështirë i punës, kjo mund të jetë arsyeja pse së fundmi Crewdson ka nisur disa vepra të thjeshta dhe më të drejtpërdrejta duke përdorur aparatit fotografik digjital dhe duke punuar pa modele, dhe atëherë fotografia mund të vazhdojë si çdo art tjetër njerëzor. Edhe pse ndodh që Crewdson vet kundërshtohet, ai mbetet tepër i ndërgjegjshëm për veprat e tij kinematografike:

"Po, unë përdor shumë materiale filmike, por e ndjej se e përdor në mënyrë fotografike, dhe jo filmike. Kam punuar në mjaft filma për të kuptuar se kur punon në një film, nuk mendon vërtetë për pikat e avantazhit, por mendon për vendin se si do të mbijetojë ndër vite. Në një fotografi, çdo detaj është i rëndësishëm. Ashtu si objektet mbi shtrat, po kështu përzihen të gjitha gjërat e vogla. Në një foto përcaktohet sfondi dhe më pas gjithçka lidhet me këtë sfond. Çdo gjë strukturohet në mënyrë të saktë. Shpresoj se fotot e përfunduara janë të bukura, të qeta, të palëvizshme dhe meditative, (Ayers, Artinfo.com)"

Kjo sepse pjesërisht fotografia është gjithçka për Crewdson-in, lektor i diplomuar në Shkollën e Arteve në Jeill. Ai pranon se filloi të nxjerrë një nga fotot më të mistershme dhe të fuqishme që mund të bënte pa hezitim dhe pa asnjë lloj frike. Gjatë një interviste për Revistën Sunday Times, ai deklaroi se përdor "gjithçka në dispozicion të tij për të arritur atë që synon". Pikërisht, kjo gjithçka, përfshin të marrësh parasysh edhe risqet në të njëjtën kohë. Njëherë Crewdson-i i zellshëm pati rastin të fotografojë një grua...

(Vijon në nr. e ardhshëm)